



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

E.Rev.nr.8/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rustem Thaqi dhe Millena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses K. "L.", me seli në P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit M. B. nga P., kundër të paditurve; 1."Fondi i Sigurimeve Shëndetësore-MSH", me adresë rr. "....", pa.nr,, Objekti ..., në P., dhe të paditurit 2.Shërbimi Spitalor i Klinikave Universitare të Kosovës, me seli në P. të cilin e përfaqëson sipas autorizimit D. Z. nga P., me objekt kontesti kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me revizionin e paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr. 832/2022, datë 18.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur 11.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditëses K. "L." me seli në P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr. 832/2022, datë 18.09.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr. 832/2022, datë 18.09.2023, është refuzuar i e pabazuar ankesa paditëses, K. "L." me seli në P., ndërsa është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.547/2018, i datës 25.01.2021, me të cilën, K. "L." me seli në P., ka kërkuar që të detyrohet i padituri Shërbimi Spitalor dhe Klinika Universitare e Kosovës, me seli në P., që t'ia paguaj shumën prej 33,652.80€, në emër të mallit të pa porositur prej 29,520 copë të barit L., shumën prej 2,102.16€, në emër të asgjësimit të mallit kontraktues-barit L., si dhe shumën prej 81,664,12€, në emër të fitimit të humbur, me kamatë ligjore prej 3.5 %, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë më 05.10.2018, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afatin kohor

prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Konstatohet se paditësi ka tërhequr padinë ndaj të paditurit së parë. "Fondi I Sigurimeve Shëndetësore-MSH" me adresë rr. "...", pa.nr. ..., Objekti ..., në P.. Secila palë në procedurë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësja me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe të dy aktgjykimet e lartpërmendura të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim ose të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet si e bazuar.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion si dhe pretendimet e revizionit të paditëses, dhe gjeti se:

Revizioni i paditëses është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh së paditësja, ka parashtruar padi më datën 05.10.2018, kundër të paditurve: 1."Fondi I Sigurimeve Shëndetësore-MSH" me adresë rr. "...", pa.nr. ... Objekti ... në P., ndaj të cilit e ka tërhequr padinë dhe kundër të paditurës 2.Shërbimi Spitalor dhe Klinika Universitar i Kosovës, me seli në P., duke kërkuar që e paditura t'ia paguaj dëmin e shkaktuar, për shkak të mos përmbushjes së kontratës së datës 18.02.2016, dëmin e shkaktuar për asgjësimin mallit të kontraktuar të baritit L. si dhe fitimin e humbur, gjithashtu ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara dhe nga deklarimi i palëve në procedurë, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar për shkak se; paditësja nuk iu ka përmbajtur kushteve të kontratës ashtu si parashihet me nenin 1.2 të kësaj kontrate me të cilën është përcaktuar se "kontrata publike kornizë do të implemtohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje, psh kurdo

që autoriteti kontraktues apo ndonjë autoritet tjetër kontraktues i përfshirë në këtë kontratë tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse," ndër të

tjerash në nenin 1.3 të njëjtës kontratë ceket se "sasi të vlerësuara, të përcaktuara në pjesën C lista e çmimit janë vetëm sasi indikative dhe nuk detyrojnë autoritetin kontraktues të blejë ndonjëherë prej tyre. Autoriteti kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë me pak ose më shumë sasi se ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (Lot) të njëjtë.

Megjithatë Autoriteti Kontraktues i përmendur në nenin 1.1 është të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallra të përmendura në 1.1" ndërsa në nenin 1.4 po të njëjtës kontratë theksohet se "Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë se +/-30% sasi se sa ato të parapara të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të mos blejë asnjë nga këto sasira për disa artikuj", andaj arsyet e përkufizimit të nenit 1.2 nga ana e Autoritetit Kontraktues ka pas për qëllim që të mos furnizohet me sasi të produktit të përcaktuar me lotin nr.28 më tepër se sa që i nevojitet, dhe ti shmanget skadimit të afatit të përdorimit të barit të lartë përmendur, po që se do të deponohet te autoriteti kontraktues, pra autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë ka theksuar me kontratë se implementimi i kontratës do të bëhet vetëm sipas porosisë së tij e jo se do ta siguroj sasinë "L." nga ana e paditëses.

Andaj, gjykata duke u bazuar sipas kësaj gjendje vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga se nuk janë plotësuar as kushtet e nenit 136 të LMD-së, në të cilën parashihet se për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të përmbushen kushtet e përgjegjësisë, të ekzistoj përgjegjësia e të paditurës, të ekzistojë fakti dëmtues dhe dëmi të shkaktuar si dhe kundërligjshmëria e veprimit me të cilën është shkaktuar dëmi. Ndërsa sipas nenit 138 të LMD- së, ekziston obligimi për kompensimin e dëmit ekziston eten në rastet që vërtetohet se dëmi është shkaktuar me fajin e dëmtuesit dhe nëse dëmtuesi ka marrë veprim (masa) për parandalimin e dëmit apo zvogëlimin e tij, andaj kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret paditësja me veprimet e veta ka shkaktuar këto dëme e jo nga veprimet e të paditurës dhe se paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë se a e ka ndërmarrë ndonjë masë për parandalimin e dëmit.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, lidhur me të gjitha pikat e dispozitivit të aktgjykimit, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta

materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, për shkak se, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës është vërtetuar se paditësja nuk iu ka përmbajtur kushteve të kontratës ashtu siç parashihet me nenin 1.2 të kontratës, ndërsa në nenin 1.4 po të njëjtës kontratë theksohet se "Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do ti lejohet të bëjë ndryshime të cmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë . Kështu paditësja sipas kontratës është dashur të furnizohej vetëm sipas sasisë së porositur nga Autoriteti Kontraktues e jo të furnizohet për tërë sasinë kontraktuese e cila do të realizohet brenda 2 vite.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e ligjit material gjegjësisht nenit 136 dhe 138 të LMD-së, sepse ekzistimi i përgjegjësisë, lidhja kauzale e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimeve të së paditurës, dëmit të pësuar dhe marrja e masave preventive përbëjnë elemente thelbësore për tu krijuar baza juridike për kërkimin e kompensimit të dëmit, dhe fitimit të humbur.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit, është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhomat e Shkallës së Dytë, dhe për të njëjtat arsye dhe shkaqe të dhëna nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses, dhe ka vërtetuar si të drejtë dhe të ligjshëm aktgjykimin e lartë përmendur, duke pranuar kështu, si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së parë të dhëna në aktgjykimin e saj.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditëses, pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave në këtë çështje kontestimore nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Edhe pse në revizion nuk janë cekur bazat ligjore të atakimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë të parapara me nenin 214 të LPK, Gjykata Supreme gjen se, nga përmbajtja e revizionit rezulton se i njëjti aktgjykim është goditur për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e më shumë për shkak të gjendjes faktike, për të cilin shkak në kuptim të nenit 214.2 të LPK, nuk mund të paraqitet revizioni.

Pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nuk u pranuan si të bazuara nga ana e Gjykatës Supreme, pasi që gjykata e shkallës së parë dhe e dytë duke e vlerësuar të njëjtin pretendim të paditëses të paraqitur edhe pranë këtyre gjykatave, kanë dhënë arsytim të plotë, të qartë dhe të pranueshëm edhe për gjykatën e revizionit lidhur me refuzimin e një pretendimi të tillë, kjo ngase sipas nenit 1.1 dhe 1.2 të kontratës kornizë të lartpërmendur, në gjendjen faktike të përshkruar si më lart rezulton se e paditura nuk ka asnjë lloj borxhi ndaj paditëses për mos përmbushje të kontratës nga viti 2016, për faktin se në njërën anë, nenin 1.1 të kësaj kontrate ka qenë e përcaktuar që bari të ofrohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, ndërsa sipas nenit 1.2 të kësaj Kontrate, palët janë dakorduar që kontrata publike kornizë, do të implementohet në bazë të porosive apo thirrjeve të autoritetit kontraktues, këtu të paditurës, dhe në anën tjetër se nuk është vërtetuar me asnjë provë se e paditura nuk ka përmbushur kontratën për të cilën janë dokorduar. Ajo për periudhën kontestuese tek paditësja nuk ka bërë asnjë lloj porosie apo thirrje në drejtim të përmbushjes së detyrimit të saj kontraktues, andaj edhe ajo nuk mund të detyrohet që të përmbush një detyrim kontraktues kur baza e atij detyrimi nuk rezulton nga dispozitat e asaj kontrate. Për këto arsye pretendimet e paditëses përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, edhe nga Gjykata Supreme u vlerësuan si të pabazuara.

Kjo gjykatë e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë kur vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se baza ligjore e kontraktimit të kontratës ka qenë Ligji i Prokurimit Publik i cili parasheh dhe rregullon procedurat për ofertimin, zgjedhjen dhe lidhjen e kontratës, ndërsa të drejtat dhe detyrimet rregullohen në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, që do të thotë me Ligjin e Prokurimit publik rregullohet procedura dhe përzgjedhja e ofertuesit, ndërsa mënyra e kontraktimit dhe kushtet e kontraktimit i rregullon Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimeve. Ligji mbi Prokurimin Publik, nuk përmban dispozita të veçanta apo speciale, që rregullon detyrimet kontraktuese. Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen

faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas Gjykatës Supreme të Kosovës nënkupton se "Kontratë publike kornizë" nënkupton një marrëveshje për një periudhë të kufizuar në mes të një apo me shume autoriteteve kontraktuese si dhe një apo më shumë operatorëve ekonomik, qëllimi i të cilës është vendosja e termave që udhëheqin kontratat që duhen dhënë gjatë një periudhë të caktuar, në lidhje me çmimin si dhe, kurdo që është e përshtatshme edhe sasinë e theksuar. Pra ,kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë (riparim/punë mirëmbajtje), e cila i vendosë termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrave mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes.

Prandaj edhe pretendimi për shkelje të nenit 1.4 të kontratës kornizë, nuk qëndron sepse këtu nuk kemi të bëjmë me ndërrim kushtesh apo tejkalim sasie por me zbatim të nenit 1 pika 1.2 dhe pika 1.3 të kontratës kornizë është e përcaktuar saktësisht në pikën 1.2 "Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. kurdo që autoriteti kontraktues apo ndonjë autoritet tjetër kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse", ndërsa në pikën 1.3 "Sasi të vlerësuara, të përcaktuara, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe nuk detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjërin prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

Gjykata vlerësoi pretendimet e të paditurës të parashtruara në revizion lidhur me aplikimin e dispozitave ligjore dhe të udhëzimit administrativ, dhe se këto pretendime janë po të njëjtat të cilat janë parashtruar edhe në ankesë dhe për të njëjtat ka dhënë përgjigje gjykata e shkallës së dytë, me të cilat përfundime dhe arsye pajtohet edhe kjo gjykatë.

Për këto arsye pretendimet e të paditurës përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, edhe nga Gjykata Supreme u vlerësuan si të pabazuara. Për faktin se me revizionin e të paditurës nuk vihet në pyetje ligjshmëria e aktgjykimit të goditur me revizion, as në aspektin procedural e as në atë material, si i tillë, revizioni i të paditurës u refuzua si i pabazuar.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura, nuk janë vlerësuar, pasi që sipas nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222, të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.8/2024, më 11.03.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami